



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Doretzuat Priljezo/Prodato Received/Deliverty	31. 12. 2021	1	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jednitca Org /Unit	Dr Prof Pr Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6482/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1056/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2321/19 të datës 18.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.246/2019 të datës 16.04.2019, të parashtruar nga _____ me adresë banimi fshati Rugovë, Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.246/2019 të datës 16.04.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 112/02-12643 i datës 27.03.2019 i Kryetarit të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankues _____ me datë 16.04.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokolli 112/02-12643 të datës 27.03.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit për shkak të mos konfirmimit të periudhës provuese.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, Këshilli me datë 17.04.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses te Komuna e Gjakovës, ndërsa me datë 30.04.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 03.09.2019 përmes shkresës me numër protokoll 4088/2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.246/2019 të datës 16.04.2019, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesi pas njoftimit të Këshillit të datës 03.09.2019, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kurse kjo e fundit me datë 18.11.2021, ka nxjerrë aktgjykimin me numër A.Nr.2321/19, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 03.09.2019 dhe ka obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër A.Nr.246/2019 të datës 16.04.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka amdinstruar këto prova: Ankesën A.nr.246/2019 të datës 16.04.2019 të parashtruar në KPMSHCK, Aktgjykimin A.nr.2321/19 të datës 18.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, Vendimin me numër protokoll 112/02-12643 datës 27.03.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës; Formularin për Vlerësimin e periudhës provuese të datës 18.03.2019, e-mailin e datës 12.03.2019 nga T.V për F.H; e-mailin e datës 27.12.2018 nga T.V për F.F, Vërejtjen më shkrim të datës 04.01.2019; përgjigjen në ankesë të datës 14.01.2019 për qytetaren S.K, Ankesën e datës 15.01.2019 të qytetarit M.B, drejtuar Drejtorisë së Administratës; Ankesën e datës 15.01.2019 të qytetarit I.M drejtuar Drejtorisë së Administratës; Ankesën e datës 31.12.2018 nga Qyetarja S.K drejtuar Drejtorisë së Administratës; Ankesën e datës 15.01.2019 të qytetarit L.B, Ankesën e datës 03.01.2019 të qytetarit A.B drejtuar Drejtorisë së Administratës; emailin e datës 29.03.2019 nga T.K për F.H, Akt Emërimit me numër protokoll 112/02-8203 të datës 04.04.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Zyrtar i Gjendjes Civile, Përgjigjen në ankesë të datës 30.04.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave pasi ka analizuar Aktgjykimin A.nr.2321/19 të datës 18.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës përkatesisht sipas Akt Emërimit me numër protokoll 112/02-8203 të datës 04.04.2018, Kolegji ka gjetur se ankuesi është emëruar Zyrtar i Gjendjes Civile 1, në Sektorin e Gjendjes Civile pranë Komunës së Gjakovës, me punë provuese duke filluar nga data 05.04.2018. Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit përmes Formularit të datës 18.03.2019, nuk ka konfirmuar periudhën provuese të ankuesit në pozitën e punës Zyrtar i Gjendjes Civil 1, më arsyetimin se i njëjti ka pasur vërejtje nga qytetarët lidhur me punën dhe sjelljen e tij në punë dhe se përkundër vërejtjeve me shkrim dhe me gojë nga mbikëqyrësi, ankuesi nuk ka bërë përmirësim. Bazuar në mos konfirmimin e periudhës provuese, Kryetari i Komunës së Gjakovës me vendim me numër protokoll 112/02-12643 të datës 27.03.2019, ankuesit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës duke filluar nga data 31.03.2019.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikeqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimi në fjalë është nxjerrë pa paralajmerim dhe së i njëjti është në kundërshtim

me Ligjin e punës, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike dhe shkelje të legjislacionit për shërbimin civil në Kosovë respektivisht Rregullores Nr.02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ju referua nenit 20 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë me të cilin është përcaktuar se: 1.Kandidatët të cilët i kanë kaluar me sukses procedurat e pranimit konsiderohen nëpunës civilë në punë provuese. 2. Të gjithë kandidatët që pranohen në Shërbimin Civil në pozitat e karrierës emërohen në punë provuese me kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) muaj. Në përfundim të periudhës së punës provuese, eprori i drejtpërdrejtë në bazë të vlerësimit pozitiv të përformancës, mbështetur në rezultatet në punë të nëpunësit civil, vendos konfirmimin ose jo të tij në atë pozitë pune, si dhe Rregulloren Nr.02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 6 ku është përcaktuar se: ...2. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë udhëzon nëpunësin civil për të drejta dhe detyrimet e tij gjatë periudhës provuese. 3. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë që në fillim e njofton nëpunësin civil për kriteret që përcaktojnë vlerësimin e punës së tij provuese si vijon 3.1 realizimi i kënaqëshëm i detyrave të punës; 3.2 gatishmëria, kreativiteti dhe vetëiniciativa për kryerje detyrave të punës; 3.3 respektimin e rregullave dhe mirësjellses në Shërbimin Civil, 3.4 repektimi i orarit te punës. 4. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë vlerëson nëpunësin civil gjatë tërë periudhës provuese dhe e informon për të arriturat dhe ngecjet në kryerjen e detyrave të punës....6. Nëpunësi civil mund të kërkoj ndihmë nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë për problemet dhe vështirësitë eventuale, që paraqiten gjatë kryerjes së detyrave të punës. 7. Gjatë punë provuese, nëpunësi civil kryen trajnimin hyrës dhe trajnime të tjera të nevojshme për pozitën e tij...". rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe bazuar në administrimin e provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se me datë 31.12.2018, 05.01.2019 dhe 03.01.2019 ndaj ankuesit janë paraqitur disa ankesa me shkrim nga qytetarët, të cilët deklarojnë se ankuesi në cilësi të zyrtarit të gjendjes civil në Zyrën e Vendit në fshatin Rugovë, nuk i'u ka ofruar shërbimet e kërkuara dhe se nuk ka treguar sjelle të mirë kundrejt tyre me rastin e ushtrimit të detyrave të punës. Po ashtu, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në cilësi të Mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 03.01.2019 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërjetje më shkrim" për shkak të mos zbatimit të detyrave të punës, vërjetjeve nga qytetarët, mos respektimin e udhëzimeve të udhëheqësit si dhe mos respektim të orarit të punës. Ndërsa po nga analizimi i Formularit për Vlerësimin e Periudhës provuese të datës 18.03.2019, Mbikëqyrësja e ankuesit ka konfirmuar se ankuesi gjatë periudhës provuese ka kryer trajnimin për certifikim në gjendjen civile duke u pajisur me certifikatë përkatëse.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor si ankuesit se i njëjti nuk është paralajmëruar lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, sepse, nga vlerësimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë përmes shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" të datës 03.01.2019, ka vë në dijeni ankuesin për mos konfirmim te punës provuese nëse i njëjti nuk tregon përmirësim në përmbushjen e detyrave të punës dhe sjelljeve të tij në punë, dhe po ashtu me datë 12.03.2019 Udhëheqësja ka ftuar në takim ankuesin për të diskutuar lidhur me vlerësimin për punën provuese të ankuesit.

Andaj, bazuar në konstatimin si me sipër, Kolegji vlerëson së udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit me rastin e mos konfirmimit të periudhës provuese të ankuesit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me nenin 20 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe nenin 9 të Rregullores Nr.02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë. Ndërlidhur me këtë edhe Kryetari i Komunës me nxjerrjen



e Vendimit te kontestuar ka vepruar në përputhje me depozitat e Rregullores 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies se Punës në Shërbim Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3 dhe nenit 8 të kësaj Rregullore, e mbi këtë bazë ligjore, rezulton se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Kështu që, bazuar në rrethanat si me lartë, Kolgji duke u bazuar me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.Nr.1056/2021

Rushit KAJTAZI

[Signature]
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi;
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

